



**AKEP**

AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE  
ELEKTRONIKE DHE POSTARE



# **Treguesit Statistikorë të Tregut të Komunikimeve Elektronike 2023**

---

**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**

**Drejtoria e Tregjeve dhe Masave Rregullatore**

<i>Treguesit kryesorë të volumit të shërbimeve celulare</i> .....	4
<i>Numri i përdoruesve celularë</i> .....	4
<i>Shërbimet e aksesit broadband në rrjetet celulare 3G/4G</i> .....	5
<i>Trafiku telefonik dhe SMS</i> .....	6
<i>Terminimi i thirrjeve dhe SMS-ve</i> .....	7
<i>Përdorimi mesatar mujor i shërbimeve celulare</i> .....	8
<i>Pjesët e tregut</i> .....	8
<i>Treguesit kryesorë të volumit të shërbimeve nga rrjetet fikse</i> .....	11
<i>Telefonia fikse</i> .....	11
<i>Aksesi broadband nga rrjete fikse</i> .....	13
<i>Numri i pajtimtarëve</i> .....	13
<i>Paketat e integruara (Bundles)</i> .....	14
<i>Teknologjia</i> .....	16
<i>Shpejtësia e aksesit broadband</i> .....	16
<i>Përdorimi i përbashkët i infrastrukturës aktive dhe pasive në rrjetet fikse</i> .....	17
<i>Të ardhurat dhe investimet</i> .....	18

## Lista e Figurave

Figura 1: Treguesit kryesorë të volumit të shërbimeve celulare 2019-2023	4
Figura 2: Numri i përdoruesve celularë aktivë dhe karta SIM 2019-2023	5
Figura 3: Struktura e thirrjeve dalëse celulare sipas destinacionit 2019-2023	6
Figura 4: Ecuria trafikut mujor on-net/off-net 2019-2023	7
Figura 5: Terminimi i thirrjeve hyrëse kombëtare dhe ndërkombëtare në rrjetet celulare (në minuta)	7
Figura 6: Ecuria e numrit të pajtimtarëve të telefonisë fikse 2019-2023	11
Figura 7: Norma e penetrimit të Telefonisë Fikse sipas qarqeve dhe zonave Urbane/Rurale (2023)	12
Figura 8: Penetrimi i aksesit broadband nga rrjete fikse sipas popullsisë dhe familjeve	14
Figura 9: Penetrimi i aksesit broadband nga rrjete fikse sipas Qarqeve (2023)	14
Figura 10: Numri i pajtimtarëve që kanë akses në shërbime të integruara (Telefoni, Internet dhe TV)	15
Figura 11: Lidhjet broadband fiks sipas teknologjisë Shqipëri 2023	16
Figura 12: Shpërndarja e pajtimtarëve me akses broadband fiks sipas shpejtësisë	17
Figura 13: Të ardhurat e sipërmarrësve të komunikimeve elektronike nga rrjetete celulare dhe ato fikse	19
Figura 14: Të ardhurat nga komunikimet elektronike për vitin 2023 sipas operatorëve kryesorë (milionë lek)	19
Figura 15: Të ardhurat totale të operatorëve celular 2019-2023 (milionë lek)	20
Figura 16: Të ardhurat me shumicë dhe pakicë nga rrjetet celulare (milionë lek)	21
Figura 17: Të ardhurat nga ofruesit e shërbimeve elektronike nga rrjetet fikse për operatorët kryesorë (milionë lek)	22

## Lista e Tabelave

Tabela 1: Numri i pajtimtarëve me akses broadband 3G/4G	5
Tabela 2: Përdorimi mesatar mujor i thirrjeve (minuta), SMS (numër), Data (GB)	8
Tabela 3: Pjesët e tregut për treguesit kryesor të shërbimeve celulare	9
Tabela 5: Numri i linjave të telefonisë fikse sipas qarqeve dhe operatorëve	12
Tabela 6: Ecuria e numrit të pajtimtarëve të aksesit Broadband nga rrjete Fikse 2019-2023	13
Tabela 8: Ofrimi me shumicë Linja/kapacitete me qira 2019-2023	18

## **Shërbimet e komunikimeve elektronike mobile dhe rrjeteve fikse**

Bazuar në rregulloren Nr.12, datë 07.04.2010 “Për të dhënat statistikore dhe financiare periodike të sipërmarrësve të rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike”, e ndryshuar, të gjithë sipërmarrësit e autorizuar për ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike të rrjeteve fikse dhe mobile janë të detyruar të raportojnë në AKEP në mënyrë periodike të dhënat e tyre statistikore dhe financiare sipas afateve të përcaktuara nga kjo rregullore.

Ky raport është përgatitur duke iu referuar të dhënave më të fundit të dërguara nga operatorët celular, si dhe të dhënave të Operatorëve Alternativ. Në disa raste AKEP nuk mund të dallojë parregullsitë e raportimit të të dhënave deri në momentin kur këto të dhëna do të krahasohen në periudhat në vijim. AKEP nuk mban përgjegjësi për cilësinë e të dhënave të raportuara nga operatorët. Për shkak të ruajtjes së konfidencialitetit të të dhënave, jo të gjithë treguesit e raportuar nga operatorët publikohen nga AKEP. Mund të ekzistojë një mospërputhje e vogël ndërmjet shumës së përbërësve dhe totalit të paraqitur nëpër tabela për shkak të rumbullakimeve. Për këtë periudhë janë përdorur raportimet e 201 sipërmarrësve që ushtrojnë aktivitet në ofrimin e shërbimeve të rrjeteve celulare, telefoni fikse dhe internet.

Gjatë vitit 2023, shërbimet e komunikimeve elektronike kanë vijuar të jenë mbështetës të rëndësishëm të lehtësimit të komunikimit ndërmjet kategorive të ndryshme të konsumatorit fundor me Qeverinë, bizneset, si dhe aktorëve të tjerë ndërlidhës të sferës ekonomiko-shoqërore.

### Treguesit kryesorë të volumit të shërbimeve celulare

Për sa i përket treguesve kryesorë të tregut celular, viti 2023 ka shënuar ndryshime të rëndësishme në strukturën e këtij tregu, siç ishte bashkimi me anë të përthithjes i operatorit Albtelecom sh.a nga operatori One Telecommunications sh.a, gjë që ka çuar në rikonfigurimin e këtij tregu. Aktualisht, duke filluar nga data 1.1.2023 në treg janë vetëm dy operatorë celularë: Vodafone Albania sh.a dhe One Albania sh.a.

Në vijim paraqitet ecuria për disa nga treguesit kryesorë të volumit të shërbimeve celulare për vitet 2019-2023 dhe norma e ndryshimit vjetor në vitin 2023.

Figura 1: Treguesit kryesorë të volumit të shërbimeve celulare 2019-2023

Viti	2019	2020	2021	2022	2023	Ndryshimi 2023/2022
<b>Numri i përdoruesve të telefonisë celulare:</b>						
- sipas kartave SIM	3,378,886	3,337,824	3,484,158	3,771,419	3,863,435	2.44%
- Përdorues aktivë	2,630,076	2,618,880	2,635,466	2,782,226	2,614,764	-6.02%
<b>Numri përdoruesve me akses broadband 3G/4G:</b>						
- Totali	2,462,057	2,469,850	2,789,023	2,794,443	2,796,271	0.07%
- Përdorues aktivë	1,789,158	1,998,579	2,056,444	2,140,180	2,082,525	-2.69%
Thirrje telefonike dalëse të përdoruesve celularë (minuta)	5,494,296,034	5,286,361,927	5,602,663,590	5,006,718,174	4,286,805,307	-14.38%
Thirrje hyrëse kombëtare (minuta)	2,318,816,619	2,306,339,577	2,501,744,337	2,159,758,675	1,649,113,325	-23.64%
Thirrje hyrëse ndërkombëtare (minuta)	213,311,650	187,708,510	144,033,382	119,836,468	101,253,187	-15.51%
Numri mesazheve SMS të dërguara nga përdoruesit	967,833,263	660,604,925	555,701,627	553,607,871	412,566,297	-25.48%
Volumi total i të dhënave të transmetuara në rrjete celulare (GB)	69,135,490	88,950,833	155,585,664	184,480,857	193,620,759	4.95%

Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët. Përpunimi AKEP.

Volumi i të dhënave të transmetuara nëpërmjet internetit në rrjetet mobile, arriti në rreth 193 milion GB. Kjo përbën një rritje rreth 4.95% krahasuar me vitin 2022.

Numri i pajtimtarëve aktivë që kanë përdorur shërbimin internet celular në fund të vitit 2023 kapi shifrën prej rreth 2 milionë pajtimtarë, çka përbën një rënie me rreth 2.69% krahasuar me vitin pararendës. Edhe pse viti 2023 shënoi finalizimin e procesit të bashkimit me përthithje të dy operatorëve celularë (Albtelecom dhe One Albania) dhe operim në treg të vetëm dy operatorëve celularë, numri i përdoruesve me akses broadband mobile është pothuajse në të njëjtin nivel me vitin 2022.


Viti 2023 shënoi ulje të treguesve kryesorë:

- përdoruesit aktivë të shërbimeve celulare;
- përdoruesit aktivë që përdorin shërbimin e aksesit në internet broadband;
- volumit të thirrjeve telefonike dalëse të përdoruesve celularë.
- volumit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare;
- volumit të thirrjeve hyrëse kombëtare;
- numrit të SMS-ve.

### Numri i përdoruesve celularë

Nga të dhënat e ecurisë së numrit të përdoruesve celularë sipas viteve vërehet se numri i pajtimtarëve të shërbimeve celulare ka shënuar rritje duke filluar nga nga tremujori i parë 2021.

Figura 2: Numri i përdoruesve celularë aktivë dhe karta SIM 2019-2023



Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët. Përpunimi AKEP.

Gjatë tremujorëve të parë të vitit 2023 vërehet një rritje e treguesve kryesor krahasuar me periudhën e mëparshme T4 2022, për tu ndjekur nga një rënie në fund të tremujorit të katërt të vitit.

### Shërbimet e aksesit broadband në rrjetet celulare 3G/4G

Numri total i përdoruesve të rrjeteve celulare që kanë përdorur aksesin broadband në internet gjatë vitit 2023 paraqitet si vijon:

- rreth 2.7 milion përdorues që e kanë përdorur rrjetin të paktën një herë gjatë vitit 2023;
- rreth 2 milion përdorues aktivë (përdorim të internetit në tre muajt e fundit).

Tabela 1: Numri i pajtimtarëve me akses broadband 3G/4G

Viti	One Albania	Vodafone Albania	Albtelecom	Total	Norma e pentrimnit për popullsi
2019	567,572	940,949	280,737	1,789,258	63%
2020	718,631	981,483	298,465	1,998,579	70%
2021	825,707	925,967	304,770	2,056,444	73%
2022	836,931	1,033,888	269,361	2,140,180	77%
2023	916,755	1,165,770		2,082,525	75%

Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët. Përpunimi AKEP.


Operatorët me rrjete 3G/4G kanë pasur rënie të numrit të përdoruesve aktivë të shërbimeve akses broadband nëpërmjet aparateve celulare, ku në fund të vitit 2023 kjo shifër arriti në rreth 2 milion, krahasuar me 2.1 milion në fund të vitit 2022.

Ndërsa numri i përdoruesve aktivë nëpërmjet kartave USB/modem për vitin 2023 arriti në rreth 23 mijë përdorues duke shënuar një rënie me rreth 13% në krahasim me vitin 2022.

### Trafiku telefonik dhe SMS

Sasia totale e thirrjeve telefonike të gjeneruara nga përdoruesit celularë gjatë vitit 2023 ishte rreth 4.3 miliard minuta, e cila përbën një rënie me 14% në krahasim me vitin 2022 (5 miliard minuta).

Figura 3: Struktura e thirrjeve dalëse celulare sipas destinacionit 2019-2023




Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët. Përpunimi AKEP.

Gjatë vitit 2023, volumi i thirrjeve kombëtare drejt rrjeteve celulare (on-net dhe off-net) ka shënuar rënie, krahasuar me vitin 2021:

- sasia e thirrjeve on-net pësoi rënie me 8%,
- thirrjet off-net pësuan rënie me 23%.

Figura 4: Ecuria trafikut mujor on-net/off-net 2019-2023



Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët. Përpunimi AKEP.


Për sa i përket thirrjeve brenda rrjetit dhe drejt rrjeteve të tjera celulare kombëtare, rezulton që gjatë vitit 2023, rreth 38% e thirrjeve të realizuara kanë qenë drejt operatorëve të tjerë celularë ‘off-net’ dhe rreth 61% brenda rrjetit ‘on-net’, duke shënuar një ndryshim me respektivisht 4 dhe 5 pikë përqindje nga viti i kaluar për të dy treguesit.

Numri i SMS-ve të dërguara gjatë vitit 2023 ishte rreth 412 milion ose rreth 25.48% më pak se në vitin e kaluar.

### Terminimi i thirrjeve dhe SMS-ve

Sasia totale e thirrjeve hyrëse të terminuara në vitin 2023 ishte rreth 1.75 miliardë minuta, që përbën rënie me 23% në krahasim me vitin paraardhës. Terminimi i thirrjeve kombëtare shënoi rënie me 8.14% për thirrjet nga rrjetet fikse dhe rënie me 23.85% për thirrjet nga rrjetet e tjera celulare. Terminimi i thirrjeve hyrëse ndërkombëtare pësoi rënie me 15.51% krahasuar me vitin 2022.

Figura 5: Terminimi i thirrjeve hyrëse kombëtare dhe ndërkombëtare në rrjetet celulare (në minuta)



Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët. Përpunimi AKEP.

SMS- të e terminuara kanë pësuar rënie me 34% gjatë vitit 2023.



**Përdorimi mesatar mujor i shërbimeve celulare**

Vlen të theksohet se gjatë vitit 2023:

- volumi mesatar mujor i thirrjeve për përdorues ka shënuar rënie me rreth 14% duke arritur në 268 minuta thirrje hyrëse dhe dalëse,
- sikundër, volumi i konsumit mesatar mujor të internetit është rritur me përafërsisht 5% duke arritur në rreth 7.64 GB në muaj

Tabela 2: Përdorimi mesatar mujor i thirrjeve (minuta), SMS (numër), Data (GB)

	2019	2020	2021	2022	2023	Ndryshimi 2023/2022
Thirrje dalëse	171	168	178	154	132	-14%
Thirrje të marra	177	174	182	157	135	-14%
MOU	348	342	360	311	268	-14%
SMS Dalese	30	21	18	17	13	-25%
Trafik Data (GB)	3.20	3.91	6.39	7.30	7.64	5%

Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët. Përpunimi AKEP.

Gjatë vitit 2023, një përdorues celular aktiv ka kryer mesatarisht 132 minuta thirrje dalëse në muaj, ka dërguar 13 mesazhe SMS dhe ka konsumuar rreth 7.64 GB në internet broadband.

Faktori kryesor që ndikon në mesataren e SMS-ve është rritja e përdorimit të shërbimeve të komunikimit (sms, voice, video) nëpërmjet aplikacioneve OTT.

Këto vlera përdorimi janë më të vogla nëse si numër përdoruesish celular i referohemi numrit total të përdoruesve sipas kartave SIM.

**Pjesët e tregut**

Nga pikëpamja e përdorimit të rrjeteve celulare, të dhënat e evidentuara nga AKEP-i tregojnë se numri total i kartave SIM arriti në rreth 3.8 milionë gjatë vitit 2023: rreth 1.4 karta SIM për banor<sup>1</sup>, shifër më e lartë se mesatarja e rajonit të Evropës dhe ajo globale, përkatësisht 1.23 dhe 1.11 karta SIM për banor. Ndërkohë numri i pajtimtarëve aktivë (që përkufizohet si pajtimtari i cili ka përdorur shërbimet celulare të paktën një herë brenda tre muajve të fundit) të shërbimeve mobile përgjatë vitit të kaluar, arriti rreth 2.6 milionë, duke shënuar rënie krahasuar me vitin e mëparshëm. Përgjatë vitit 2023 ka vijuar tendenca e ndryshimit të strukturës së pajtimtarëve, ku vihet re një ulje e numrit të pajtimtarëve me parapagim (62% nga 68% që ishte në vitin 2022), dhe një rritje simetrike e blerjes së shërbimeve mobile përmes kontratave me paspagim, praktikë e cila aplikohet gjerësisht në vendet e rajonit dhe të BE-së.

<sup>1</sup> <https://www.itu.int/en/ITU-D/Statistics/Documents/facts/FactsFigures2023.pdf>

Tabela 3: Pjesët e tregut për treguesit kryesor të shërbimeve celulare

		One Albania	Vodafone	Albtelecom	HHI
Përdorues shërbime celulare (karta SIM përfshirë Broadband Data Card)	2019	33%	50%	17%	3,883
	2020	37%	47%	16%	3,833
	2021	40%	44%	16%	3,811
	2022	38%	49%	13%	4,034
	2023	53%	47%		5,013
		One Albania	Vodafone	Albtelecom	HHI
Përdorues Aktivë të shërbimeve celulare	2019	36%	48%	16%	3,849
	2020	37%	47%	16%	3,829
	2021	39%	45%	15%	3,834
	2022	40%	47%	13%	3,988
	2023	49%	51%		5,001
		One Albania	Vodafone	Albtelecom	HHI
Përdorues aktivë broadband (3G/4G)	2019	32%	53%	16%	4,018
	2020	36%	49%	15%	3,928
	2021	40%	45%	15%	3,859
	2022	39%	48%	13%	3,994
	2023	44%	56%		5,072
		One Albania	Vodafone	Albtelecom	HHI
Thirrje dalëse	2019	34%	53%	13%	4,112
	2020	34%	53%	13%	4,166
	2021	39%	50%	11%	4,151
	2022	41%	49%	10%	4,196
	2023	45%	55%		5,056
		One Albania	Vodafone	Albtelecom	HHI
SMS dalëse	2019	26%	60%	14%	4,483
	2020	26%	60%	14%	4,464
	2021	28%	58%	14%	4,340
	2022	40%	49%	12%	4,085
	2023	42%	58%		5,129
		One Albania	Vodafone	Albtelecom	HHI
	2019	24%	59%	16%	4,113

<b>Trafiku të dhëna (Gbyte)</b>	2020	23%	64%	13%	4,675
	2021	32%	56%	12%	4,201
	2022	34%	57%	9%	4,405
	2023	46%	54%		5,032
<b>One Albania    Vodafone    Albtelecom    HHI</b>					
<b>Të ardhura totale nga komunikimet</b>	2019	31%	54%	14%	4,149
	2020	34%	53%	13%	4,129
	2021	35%	52%	13%	4,110
	2022	36%	52%	12%	4,155
	2023	44%	56%		5,070
<b>One Albania    Vodafone    Albtelecom    HHI</b>					
<b>Të ardhura retail</b>	2019	31%	55%	14%	4,156
	2020	33%	54%	14%	4,139
	2021	35%	53%	12%	4,178
	2022	35%	53%	11%	4,230
	2023	44%	56%		5,074

Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët. Përpunimi AKEP.

Edhe gjatë vitit 2023, sipërmarrësi Vodafone Albania vazhdon të jetë operatori me pjesën më të madhe të tregut për të gjithë treguesit kryesorë të shërbimeve të komunikimeve elektronike mobile. Konkretisht pjesët e tregut për vitin 2023 për sipërmarrësin Vodafone Albania sha, variojnë me:

- rreth 47% të pjesës së tregut për përdoruesit e SIM card;
- rreth 51% të pjesës së tregut për përdoruesit e SIM card aktivë;
- rreth 55% të tregut për thirrjet dalëse;
- rreth 54% të tregut për volumin e të dhënave (internetit);
- rreth 56% të tregut për përdoruesit aktivë të internetit (broadband);
- rreth 56% të tregut përkatësisht të të ardhurave totale dhe ato nga shërbimet me pakicë.

Pjesët e tregut për disa nga treguesit kryesorë për sipërmarrësi One Albania janë si mëposhtë:

- rreth 53% të pjesëve të tregut për përdoruesit e SIM card;
- rreth 49% të pjesës së tregut për përdoruesit e SIM card aktivë;
- rreth 45% të tregut për thirrjet dalëse;
- rreth 46% të tregut për volumin e të dhënave (internetit);
- rreth 44% të tregut për përdoruesit aktivë të internetit (broadband) ;
- rreth 44% të tregut përkatësisht të të ardhurave totale dhe ato nga shërbimet me pakicë.

**Treguesit kryesorë të volumit të shërbimeve nga rrjetet fikse****Telefonia fikse**

Sipas të dhënave statistikore të depozituara në AKEP rezultojnë se numri i operatorëve të autorizuar të rrjeteve të telefonisë fikse, që kanë raportuar se kanë pasur aktivitet gjatë 2023 në telefoninë fikse është rreth 24 dhe 186 operatorë kanë ofruar shërbimet broadband fikse.


Pjesa më e madhe e operatorëve alternativ janë të vegjël dhe me prani shumë të kufizuar rrjeti në zona urbane apo rurale afër qendrave urbane.

Ofrimi i shërbimeve të telefonisë fikse për kryerjen e thirrjeve *voice* gjithnjë e më shumë e ka ulur pjesën e saj në treg, kjo edhe si rezultat i lehtësisë dhe rritjes së vazhdueshme të shërbimeve nga rrjetet celulare. Shërbimi i telefonisë fikse ofrohet kryesisht si pjesë e paketave të shërbimeve të rrjeteve fikse të kombinuara (internet, IPTV, telefoni fikse dhe së fundmi edhe mobile), trendi rënës për këtë tregues evidentohet në të gjitha ekonomitë e botës.

Numri i pajtimtarëve të telefonisë fikse në Shqipëri në vitin 2023 ka pësuar një rënie rreth 2%, konkretisht nga 177 mijë në fund të vitit 2022 në 173 mijë në fund të vitit 2023.

Norma e penetrimit për telefoninë fikse (numër pajtimtarësh për 100 banorë) në fund të vitit 2023 arriti në 6.3%, në të njëjtin nivel me vitin 2022.

Figura 6: Ecuria e numrit të pajtimtarëve të telefonisë fikse 2019-2023



Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët. Përpunimi AKEP.

Tabela 4: Pjesët e tregut sipas numrit të pajtimtarëve të telefonisë fikse 2019 – 2023

	One Albania	Vodafone Albania	ASC	Abissnet	Nisatel	OA të tjerë	Total
<b>2019</b>	176,653	11,409	35,558	4,095	4,098	11,046	242,859
<b>2020</b>	168,142	8,524	30,399	4,154	4,122	8,128	223,469
<b>2021</b>	152,829	8,355	20,583	4,191	4,164	7,568	197,690
<b>2022</b>	143,150	7,726	11,804	4,231	4,121	6,214	177,246
<b>2023</b>	139,763	8,742	11,777	4,216	3,320	5,317	173,135
<b>Ndryshimi 2023/2022</b>	-2%	13%	0%	0%	-19%	-14%	-2%


Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët. Përpunimi AKEP.

Siç vërehet nga të dhënat e paraqitura në tabelën sa më sipër, operatori me pjesën më të madhe në treg është One Albania me rreth 81%, i ndjekur nga ASC me rreth 7%, Vodafone Albania me rreth 5%, Nisatel dhe Abissnet me nga 2% dhe OA të tjerë me 3%. Ajo që konstatohet është se për vitin 2023 pjesa e pajtimtarëve për të gjithë operatorët kryesor ka pësuar rënie krahasuar me vitin 2022, ndërkohë që Vodafone ka pasur rritje me 13%.

Në figurën në vijim paraqitet norma e penetrimit të telefonisë fikse sipas Qarqeve në nivel urban dhe rural.

Të dhënat për numrin e pajtimtarëve sipas qarqeve tregojnë se rreth 54% e të gjithë pajtimtarëve të telefonisë fikse janë në qarkun e Tiranës. Diferenca në nivelin e përdorimit në zona urbane dhe rurale është e madhe.

Figura 7: Norma e penetrimit të Telefonisë Fikse sipas qarqeve dhe zonave Urbane/Rurale (2023)



Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët. Përpunimi AKEP.

Sasia totale e thirrjeve të gjeneruara nga rrjetet fikse në vitin 2022 pësoi rënie me 30%, si rrjedhojë e rënies së sasisë së thirrjeve telefonike të gjeneruara nga pajtimtarët e rrjetit fiks të One Albania, gjithashtu mesatarja e minutave të thirrjeve në muaj për përdorues të rrjetit fiks të One Albania është ulur nga 18 minuta në vitin 2022 në 12 minuta në vitin 2023.

Tabela 4: Numri i linjave të telefonisë fikse sipas qarqeve dhe operatorëve

Qarku	Total	One Albania	Vodafone	ASC	OA të tjerë
Berat	6,963	6,729	132		102
Dibër	2,183	2,181	1	1	
Durrës	13,037	11,896	304	273	564
Elbasan	6,253	6,024	220	2	7
Gjirokastrë	7,238	6,530	14		694
Fier	5,629	4,817	537	2	273
Korçë	12,504	11,119	1,130	103	152
Kukës	2,201	2,200			1
Lezhë	4,469	4,411	15	9	34
Shkodër	6,079	4,945	342		792
Tiranë	94,048	69,869	5,760	11,382	7,037
Vlorë	12,531	9,042	287	5	3,197

Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët. Përpunimi AKEP.

One Albania është operatori i vetëm me shtrirje të rrjetit në të gjitha qarqet e vendit, si edhe zotëron një pjesë të konsiderueshme të infrastrukturës kombëtare për ofrimin e shërbimeve nga rrjetet fikse. Operatorët e tjerë, janë të përqendruar në qarqet më të mëdha të vendit, kryesisht zonat me densitet të lartë të popullsisë.

### Akresi broadband nga rrjete fikse

#### Numri i pajtimtarëve

Tregu i ofrimit të shërbimeve broadband nga rrjetet fikse karakterizohet nga një numër i lartë pjesëmarrësish dhe si rezultat në këtë treg konkurrueshmëria është e lartë. Vetëm disa nga subjektet pjesë e këtij tregu kanë shtrirje të gjerë në disa qarqe të vendit, pjesa tjetër konkurrojnë në segmente më të vogla kryesisht janë ofrues lokalë.

Numri pajtimtarëve me akses *broadband* fiks në fund të vitit 2023 për herë të parë tejkaloi shifrën e 632 mijë pajtimtarëve, duke u rritur me rreth 8% në krahasim me vitin 2022.

Tabela 5: Ecuria e numrit të pajtimtarëve të aksesit Broadband nga rrjete Fikse 2019-2023

	One Albania	Vodafone Albania	Abissnet	ASC	Nisatel	Digicom	OA të tjerë	Total
2019	133,515	74,708	40,849	52,773	13,809	18,516	102,022	436,192
2020	128,877	95,558	41,576	58,529	17,609	22,400	144,388	508,937
2021	118,130	111,072	42,338	59,275	20,586	24,850	183,143	559,394
2022	113,197	126,115	43,175	60,282	22,386	27,097	193,033	585,285
2023	139,318	127,733	43,284	61,332	24,480	31,987	204,625	632,759
<b>Ndryshimi 2023/2022</b>	<b>23%</b>	<b>1%</b>	<b>0%</b>	<b>2%</b>	<b>9%</b>	<b>18%</b>	<b>6%</b>	<b>8%</b>

Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët. Përpunimi AKEP.

Për vitin 2023 operatorët me pjesët më të madhe të tregut fiks janë renditur si më poshtë:


- One Albania zotëron rreth 22% pjesë tregu;
- Vodafone Albania zotëron 20% pjesë tregu;
- ASC zotëron 10% pjesë tregu;
- Abissnet me rreth 7% pjesë tregu;
- Digicom zotëron rreth 5% pjesë tregu;
- Nisatel zotëron 4% pjesë tregu;
- OA (operator të tjerë), me 32% të tregut.

Gjatë viteve të fundit është vërejtur ofrimi i shërbimeve të kombinuara të rrjeteve fikse me ato mobile, duke promovuar paketa që sjellin përfitime në të dy tregjet nëse përdorin shërbime të kombinuara.

Grafiku i mëposhtëm paraqet ecurinë e penetrimit të aksesit broadband nga rrjete fikse për popullsi dhe për numër familjesh gjatë periudhës 2019-2023. Në vitin 2023 norma e penetrimit të aksesit broadband nga rrjete fikse ishte rreth 88% për familje dhe 22.9% për popullsi.

Figura e mëposhtme paraqet ecurinë e penetrimit të aksesit broadband nga rrjete fikse për popullsi gjatë periudhës 2019-2023.


Figura 8: Penetrimi i aksesit broadband nga rrjete fikse sipas popullsisë dhe familjeve<sup>2</sup>



Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët. Përpunimi AKEP.

Bazuar në të dhënat rajonale në 2023 vërehet se qarqet me normat më të larta të penetrimit urban janë Tirana dhe Korça, përkatësisht me nga 50.53% dhe 34.32% ndërsa Durrësi është qarku që ka normën më të lartë të penetrimit rural rreth 15%, i ndjekur nga Korça dhe Shkodra me nga 12%.

Figura 9: Penetrimi i aksesit broadband nga rrjete fikse sipas Qarqeve (2023)



Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët. Përpunimi AKEP.

Të dhënat e mësipërme tregojnë për një normë relativisht të ulët të penetrimit të internetit nëpërmjet rrjeteve fikse në zonat urbane mesatarisht 34% dhe në zonat rurale mesatarisht 9%.

### Paketat e integruara (Bundles)

Strategjia e konsumit drejt paketave bundle me shërbime të integruara thirrje telefonike kombëtare, SMS dhe akses në Internet e shoqëruar me ndryshimet e cituara ka çuar në krahasim

<sup>2</sup> Të dhënat e popullsisë sipas INSTAT, numri familjeve sipas Census 2011.


më të lehtë të paketave të një operatori dhe ato midis operatorëve të ndryshëm dhe kontroll më të lehtë të shpenzimeve nga përdoruesit celularë. Tendenca e operatorëve celularë në ofrimin e paketave për përdoruesit me parapagim është ofrimi i tyre në bazë konsumi 1 ditor, javor dhe mujor (30 ditor), duke përfshirë në shumicën e tyre përveç thirrjeve telefonike dhe SMS edhe akses në Internet. Këto paketa krijojnë mundësinë e zgjedhjes për përdoruesit me parapagim dhe janë lehtësisht të krahasueshme në bazë të çmimit, njësive të konsumit të përfshira në paketa dhe kohëzgjatjes së tyre.

Ofrimi i shërbimeve të rrjeteve fikse me paketa të integruara të shërbimeve të aksesit në internet, telefonisë fikse dhe TV (CaTV ose IPTV), rezulton të jetë forma predominuese e konkurrencës midis operatorëve të rrjeteve fikse.

Numri i pajtimtarëve të rrjeteve fikse që kanë akses në shërbime të integruara dyfishe ose trefishe (kombinim Telefoni/Internet/ TV) në fund të vitit 2023 arriti në rreth 295 mijë, rreth 6% më pak se në vitin 2022.

Në vitin 2023 pajtimtarët me paketa të integruara përbënin 47% të pajtimtarëve me akses broadband në rrjete fikse, ndërsa 24% e pajtimtarëve me paketa të integruara janë me paketa trefishe (Telefoni, Internet dhe TV).

Figura 10: Numri i pajtimtarëve që kanë akses në shërbime të integruara (Telefoni, Internet dhe TV)



Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët. Përpunimi AKEP.

Numri i pajtimtarëve me shërbime të integruara në shporta *triple play* (Telefoni, Internet dhe TV), ka rënie rreth 4% krahasuar me vitin 2022.




Nga të dhënat e paraqitura në figurën e mësipërme, vërehet se përdorimi i shërbimeve të integruara (Internet dhe TV) rezulton të jetë më i përdoruri ndër tre klasifikimet dhe është shoqëruar me një rënie gjatë vitit 2023 në krahasim me vitin 2022 (rreth 9%), ndërsa rënie të ka pasur edhe përdorimi i shërbimeve të integruara (telefoni fikse, Internet dhe TV) i cili arriti në rreth 69 mijë gjatë vitit 2023 ose (rreth 4%) rënie në krahasim me vitin 2022. Ndërkohë që pjesa e tregut për shërbimet e integruara (Telefoni fikse dhe Internet) ka pësuar rënie me (rreth 1%) krahasuar me vitin 2022.

### Teknologjia

Teknologjia kryesore për ofrimin e aksesit broadband në rrjete fikse është FTTH/FTTB duke shënuar rritje me rreth 17% krahasuar me vitin 2022 e ndjekur nga lidhjet Modem kabllor koaksial (TV) dhe DSL. Shumica e lidhjeve DSL janë me rrjete të kombinuara fibër optike dhe bakri (FTTN/FTTC). Vlen të theksohet se gjithnjë e më shumë sipërmarrësit që ofrojnë shërbimet broadband nga rrjetet fikse po i zhvendosin linjat e tyre nga lidhjet me DSL (dhe kombinimet me të) drejt ofrimit të këtij shërbimi nëpërmjet fibrave optike FTTH/FTTB, të cilat mundësojnë transmetim me shpejtësi dhe cilësi shumë herë më të lartë se DSL. Në fund të vitit 2023 numri i lidhjeve bazuar në teknologjinë DSL- FTTN/FTTC është ulur në rreth 48 mijë nga rreth 85 mijë që numëronte në vitin 2021, sikundër numri i lidhjeve me teknologjinë FTTH/FTTB në fund të vitit 2023 arriti në mbi 417 mijë nga rreth 314 mijë në vitin 2021.

Figura 11: Lidhjet broadband fikse sipas teknologjisë Shqipëri 2023



Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët. Përpunimi AKEP.

### Shpejtësia e aksesit broadband

Përmirësimi i cilësisë së ofrimit të shërbimit të internetit vërehet edhe në tregun e ofrimit të shërbimeve broadband nga rrjetet fikse. Në vitin 2023 rritjen më të madhe e kishte pjesa e pajtimtarëve me lidhje broadband me shpejtësi mbi 1 Gbps, duke rezultuar në 2-fishim të


pajtimtarëve krahasuar me vitin 2022, ndjekur nga lidhje broadband me shpejtësi 100 Mbps deri në 1 Gbps me rreth 2-fishim të pajtimtarëve krahasuar me vitin 2022.

Gjatë vitit 2023, pjesa e pajtimtarëve që përdorin shpejtësi më shumë se 10 Mbps ka arritur në 94%, krahasuar me rreth 87% që ishte në vitin 2022. Zhvendosja e pajtimtarëve drejt paketave që ofrojnë shpejtësi interneti më të lartë i mundëson përdoruesve të marrin shërbimet e kërkuara me cilësi më të lartë dhe pa ndërprerje.

Për sa i përket rritjes së niveleve të shpejtësisë së ofruar vlen të theksohet se gjatë vitit 2023 është evidentuar një rritje e konsiderueshme e pajtimtarëve që përdorin rrjet me shpejtësi më të madhe se 100 Mbps, ku nga rreth 72,241 në vitin 2022, ky numër ka arritur në 179,537 në vitin 2023.

Rritja e ndjeshme e numrit të pajtimtarëve që kanë akses në lidhje fikse me shpejtësi më shumë se 100 Mbps është një tregues mjaft pozitiv në funksion të arritjes së objektivave të parashikuara në planin kombëtar të broadband për infrastrukturë digjitale broadband të shpejtësisë së lartë dhe shumë të lartë në të gjithë vendin, për të ngritur themelet për një shoqëri Gigabit.

Figura 12: Shpërndarja e pajtimtarëve me akses broadband fiks sipas shpejtësisë



Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët. Përpunimi AKEP.

### Përdorimi i përbashkët i infrastrukturës aktive dhe pasive në rrjetet fikse

Në infrastrukturën aktive të shërbimeve të internetit nga rrjetet fikse me pakicë numri i bizneseve është 5,923 ndërkohë që numri i linjave të dhëna me qira është 3,589 me kapacitet total rreth 204,156 Mbit/s. Ndërsa numri i i operatorëve që ofrojnë akses me shumicë është 134 me 1,450 linja që arrijnë kapacitetin 276,960 Mbit/s.

Për sa i përket infrastrukturës pasive kontribuesi kryesor ka qenë One Albania, i cili ka ofruar akses në vitin 2023 në 1,535 km dark fibër, 56 km tubacione dhe 160 akses në rrjetin ajror. Sipërmarrësit e tjerë që kanë rritur aksesin në dhënien me qira të fibrës optike të pandriçuar (dark fibër) janë: Albanian Telecommunications Union me 335 km, Pronet me 220 km, Abissnet me 147 km, etj. Ndërsa për sa i përket aksesit në tubacione sipërmarrësit e tjerë që kanë ofruar akses janë: Abissnet me 4 km dhe ASC me 2 km.

One Albania është ofruesi kryesor i aksesit me shumicë në elementët aktivë dhe pasivë të infrastrukturës në rrjete fikse. Për vitin 2023, 65% e fibrës optike, 50% e aksesit në tubacione dhe 84% e aksesit në rrjetin ajror janë ofruar nga One Albania.

Tabela 6: Ofrimi me shumicë Linja/kapacitete me qira 2019-2023

	2019	2020	2021	2022	2023	Ndryshimi 2023/2022
<b>Ofrim akses në infrastrukturë aktive</b>						
Numri i linjave/lidhjeve të dhëna	2,295	1,432	1,018	1,291	1,450	12%
Kombëtare	2,265	1,404	991	1,228	1,382	13%
Ndërkombëtare	30	28	27	63	68	8%
Kapaciteti total i dhënë me qira (Mbps)	208,661	194,143	197,912	299,622	276,960	-8%
Kombëtare	206,148	191,713	195,360	291,910	184,060	-37%
Ndërkombëtare	2,513	2,430	2,552	7,712	92,900	1105%
<b>Ofrim Akses në Infrastrukturë Pasive (Km)</b>						
Dark fiber	1,891	2,084	2,634	2,943	2,373	-19%
Akses në tubacione	78	76	76	73	111	52%
Aksesin në rrjetin ajror	N/A	N/A	367	266	191	-28%

Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët. Përpunimi AKEP.

## Treguesit kryesorë të të ardhurave dhe investimeve


### Të ardhurat dhe investimet

Nga raportimet e kryera gjatë vitit 2023, ofruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike raportuan në total rreth 37.2 miliardë lekë të ardhura nga komunikimet elektronike, shifër kjo rreth 2% më e ulët se ajo e vitit 2022.

Në rënien e të ardhurave totale të tregut peshën kryesore e ka pasur rënia e të ardhurave të gjeneruara nga ofrimi i shërbimeve të rrjeteve fikse.

Grafiku në vijim paraqet të ardhurat e sipërmarrësve të komunikimeve elektronike totale dhe të ndara sipas tregjeve fikse dhe celulare.

Figura 13: Të ardhurat e sipërmarrësve të komunikimeve elektronike nga rrjetete celulare dhe ato fikse




Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët. Përpunimi AKEP.

Në tregun e ofrimit të shërbimeve celulare gjatë vitit 2023 operatorët kanë raportuar një xhiro prej 25.4 miliardë lekë, njësoj si në vitin 2022.


Në lidhje me nivelin e të ardhurave për disa nga sipërmarrësit kryesor në tregun e komunikimeve elektronike na informon figura në vijim.

Figura 14: Të ardhurat nga komunikimet elektronike për vitin 2023 sipas operatorëve kryesorë (milionë lek)



Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët. Përpunimi AKEP.

Figura 15: Të ardhurat totale të operatorëve celular 2019-2023 (milionë lek)



Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët. Përpunimi AKEP.

Gjatë vitit 2023 të ardhurat totale të gjeneruara nga ofruesit e shërbimeve mobile paraqiten në të njëjtin nivel me vitin e kaluar, rritje ka shënuar Vodafone Albania me rreth 8%.

Për vitin 2023 ARPM<sup>3</sup> (Average revenue Per Minute) ishte 4.78 lekë/minutë ose 27% më shumë se viti i mëparshëm, ndërkohë që ARPU<sup>4</sup> (Average Revenue Per User) ishte 7,907 lekë/përdorues ose 16% më shumë se në vitin 2022.


Në vitin 2023 një përdorues aktiv celular ka paguar mesatarisht rreth 4.78 lekë/minutë (pa TVSH) dhe shpenzuar mesatarisht 658 lekë/muaj (pa TVSH) për shërbime celulare: 132 minuta thirrje dalëse, 13 SMS dhe rreth 7.64 GB internet.

Për sa i përket treguesve të rezultatit financiar neto vjetor, të dy sipërmarrësit kanë raportuar rezultat financiar pozitiv: Vodafone Albania me rreth 549 milionë lekë fitim, që shënon përmirësim nga humbja në vitin e kaluar, One telecommunications ka raportuar fitim në vlerën 70 milionë lekë, ndryshe nga rezultati negativ i vitit të mëparshëm.

<sup>3</sup> ARPM (Average revenue Per Minute) llogaritet si raport i të ardhurave nga shërbimet me pakicë me sasinë e minutave dalëse dhe tregon të ardhurat e sipërmarrësit për një minutë.

<sup>4</sup> ARPU (Average Revenue Per User) llogaritet si raport i të ardhurave nga shërbimet me pakicë me numrin total të përdoruesve aktivë dhe tregon të ardhurat mesatare vjetore të sipërmarrësit për një përdorues.

Figura 16: Të ardhurat me shumicë dhe pakicë nga rrjetet celulare (milionë lek)



Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët. Përpunimi AKEP.

Siç vërehet në grafikun më sipër të ardhurat nga shërbimet e ofruara me shumicë për vitin 2023 kanë pësuar një rënie të konsiderueshme, ndërkohë që të ardhurat e gjeneruara nga shërbimet me pakicë kanë vijuar rritjen edhe për periudhën 2022-2023.

Megjithëse në vlerë më të ulët se në vitin 2022, edhe për gjatë vitit 2023 kanë vijuar investimet në rrjetet e ofrimit të shërbimeve celulare, ku vërehet se gjatë këtij viti janë investuar më shumë se 1.8 miliardë lekë. Rreth 83% e vlerës së investimeve të raportuara kanë shkuar në funksion të përmirësimit të infrastrukturës së ofrimit broadband nga rrjetet celulare.

Konkretisht për vitin 2023:

- Vodafone Albania ka investuar në total rreth 854 milionë lekë,
- One Albania ka investuar në total rreth 976 milionë lekë.

Të ardhurat nga komunikimet elektronike të raportuara nga ofruesit e shërbimeve nga rrjetet fikse për vitin 2023 tejkaluan vlerën prej 11.8 miliardë lekë. Kjo përbën një rënie me rreth 7% në krahasim me vitin 2022.


Më shumë se 82% e të ardhurave të këtij tregu gjenerohen nga 8 operator kryesorë, konkretisht:

- One Albania sh.a (34%);
- Vodafone sh.a (22%);
- ASC (7%);
- Digicom (5%);
- Abissnet (4%);
- Nisatel dhe ATU me nga (3%);
- FBD (2%);
- Operatorët e tjerë (OA) rreth 18% të të ardhurave të këtij tregu.

Bazuar në raportimet e kryera, përgjatë vitit 2023, sipërmarrësit e rrjeteve fikse kanë kryer rreth 2.7 miliardë lekë investime të cilat kryesisht kanë si destinacion përmirësimin e aksesit të

shërbimeve broadband, ku ndër investimet kryesore është fokusimi drejt zhvendosjes së rrjeteve të transmetimit nga teknologjia DSL drejt teknologjisë me fibër.

Figura 17: Të ardhurat nga ofruesit e shërbimeve elektronike nga rrjetet fikse për operatorët kryesorë (milionë lek)



Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët. Përpunimi AKEP.

Tregu i shërbimeve elektronike është një ndër sektorët që ka një kontribut mjaft të rëndësishëm edhe në punësim. Për vitin 2023 ky treg numëron më shumë se 3,291 të punësuar.